

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

P.nr.84/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË –Departamenti i përgjithshëm me gjyqtarin e vetëm gjykues Mentor Hajraj dhe me procesmbajtësin Gezim Ademi , duke vendosur ne lëndën penale ndaj të pandehurit _____, me vendbanim ne Mitrovicë ne Rr. _____ "pn." ndërtesa nr. _____ ku edhe tani jeton, i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Mitrovicë PP.II.nr. _____ /2014 te dt.04.06.2014 për shkak veprës penale Kanosje nga neni 185 par.1 te KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.22.01.2016, i cili ishte publik e verbal, ne te cilën ishin prezent Prokurori i Shtetit pran Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë-departamenti i përgjithshëm Fetije Bajrami-Shala dhe i pandehuri _____, me dt. 25.01.2016, mori dhe me pas publikisht e shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri _____, me nofkën _____, nga babai _____ dhe nëna _____ mbiemri i vajzërisë _____ i lindur me 15.09.1980 ne Mitrovicë ku edhe tani jeton ne Rr. _____ "pn," _____, ndërtesa nr. _____ me numër personal _____, serb, shtetas i Republikës se Kosovës, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt.30.05.2014, rreth orës 16.10 minuta ne Mitrovicë, rruga e _____ me qellim frikësimin dhe shkaktimit te një te keqeje seriozisht ka kanos nenën e tij ashtu qe i njëjti duke vepruar nen ndikimin e alkoolit dhe atë prej 2.59 promila fillimisht përmes telefonit i dërgon mesazh kërcënues "nene me dërgo minutat mos me shti te hy ne te kuqen", dhe pas 10 minutash i është drejtuar " do te beje hara kiri".

Me këtë ka kryer veprën penale- Kanosje nga neni 185 par.1 te KPRK-së.

Andaj, gjykata ne baze te se njëjtës dispozite ligjore lidhur me nenet 4, 7, 17, 41, 49, 50, 51, 52 dhe 73 te KPRK-së, si dhe neneve 450 par.1 dhe 2 nen par. 2.6, 453 par.1, 463 par. 1 dhe 2 dhe nenit 365 te KPP-së e;

GJYKON

- Me dënim me burg ne kohëzgjatje prej katër/4/muajsh, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne afatin prej një/1/ viti.
- Obligohet i pandehuri qe ne emër te shpenzimet te procedurës penale te paguaj shumen prej 30 €/tridhjetë euro/ ndërsa në emër te paushallit gjyqësor obligohet qe te paguaj shumen prej 20€/njëzet euro/, të cilat është i obliguar qe t'i paguaj ne afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.



- Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - dep. i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP-II-nr. /2014, te dt.04.06.2014, e ka akuzuar te pandehurin / / , nga Mitrovica ku edhe tani jeton ne Rr." ' pn, " ,ndërtesa nr. , për shkak te veprës penale - Kanosje nga neni 185 par.1 te KPRK-se, te cilën akuze ne gjykate e përfaqësoi prokuroria e shtetit Fetije Bajrami-Shala.

Gjate shqyrtimit fillestar i pandehuri e pranoj ne tërësi fajsinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe deklaroi se të njëjtën e ka kryer ashtu siç është e parashkruar ne dispozitivin e aktakuzës.


Pas pranimit te fajësisë nga i pandehuri gjykata e kërkoj mendimin nga prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, e cila mes tjerash deklaroi se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është e mbështetur ne prova materiale prova nga të cilat është ngritur aktakuza, andaj vlerësoj së ky pranim është bërë ne mbështetje te këtyre provave materiale dhe ne pajtim me vullnetin e te pandehurit dhe se nuk është ne kundërshtim me arsyet ne te cilat është ngritur aktakuza.

Pas pranimit te fajësisë nga i pandehuri dhe pas marrjes se mendimit nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues ne bazë te dispozitës ligjore te nenit 248 par.4 te KPP-ës , ka marr vendim me te cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet ne barrë sipas kësaj aktakuze nga se konsideroj se pranimi i fajësisë është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit te fajësisë, i cili pranim është mbështetur ne provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e kësaj lende, dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ndaj këtij te pandehuri duke i shqiptuar dënim si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para së gjithash në bazë të pranimit të fajësisë nga i akuzuari, pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në aktakuzë dhe nga provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lendes, si raportet policore si dhe shkresat tjera te lendes sipas rastit 2014- nga vështrim ne mesazhet e fiksuar nga telefoni i te dëmtuarës i dt. 30.05.2014, dhe nga foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera te cilat gjenden ne shkresat e lendes.

Andaj duke u mbështetur ne këto fakte dhe prova te cilat gjenden ne shkresat e lëndës ne veprimet e te akuzuarit përmbushen te gjitha elementet e veprës penale- Kanosje nga neni 185 par.1 te KPRK-se, për çka gjykata te akuzuarin e shpalli penalisht përgjegjës dhe i shqiptoj dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara ne nenin 73 të KPRK-ës, e në rastin konkret për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti faktin së i njëjti gjate shqyrtimit fillestar e pranojë fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej ne barre me çka gjykatës i ndihmojë ne mase te madhe ne vërtetimin e drejt te gjendjes faktike, si dhe gjendjen e tije jo te mire ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti faktin se me rastin e kryerjes se veprës penale i pandehuri ka futur frike tek e dëmtuara , andaj gjykata të





akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke pritur me të drejt se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-ës

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori ne bazë te nenit 450 par.1 dhe 2 nen par. 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-ës.

Vendimin mbi udhëzimin e palës se dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e mori sipas nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-ës.

Nga si u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Departamenti i përgjithshëm
P.nr.84/2014, i dt.25.01.2016

Procesmbajtësi
Gëzim Ademi

Gjyqtari i vetëm gjyqësor
Mentor Hajraj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh pas pranimit te këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.